

AKT THEMELIMI "ALF SH.P.K."



Në Korçë sot më datë 20.06.1994 (nëntëdhjetëkatërt),
urë i mënshkruari Lulëzim Ruka, i biri i Sefendinit i datiliindjes
17.05.1955 banues në Tiranë, në lagjen Nr.7, pallatai Nr.6 me
Letër rjoftimi personal Nr.345404 me cilësinë e ortakëve.

1. Arjan Vait Cerkollari banues në fshatin Leminot-Korçë
i datëliindjes 03.10.1971, me Nr.Letërr-joftimi personal 230982.

2. Alfred Vait Cerkollari i datëliindjes 19.07.1973, banues
në fshatin Leminot-Korçë me Nr.letërr-joftimi personal Nr.243084.

Me vullnetin tonë të lirë e të plotë, vendosëm të krijojmë
shoqërinë tregëtare private me "Përgjegjësi të kufizuar", "ALF SH.P.K"
me seli në Leprakë Tiranë, Lagjia Nr.7 Pall.6.

H Y R J E

Në kuptim të këtij akti themelues, ortakët Lulëzim Ruka,
Arjan Cerkollari dhe Alfred Cerkollari janë themelues të shoqërisë
tragëtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ALF SHPK" Korçë.

Qëllimi i këtij akti themelues është krijimi i shoqërisë
me përgjegjësi të kufizuar "ALF SHPK"; me seli ~~Leminot~~ dhe shtri-
rjen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria "ALF SHPK" Korçë regulloi veprimtarinë e saj
tregëtare në përputhje me akt-themelimin, statusin e saj më ligjin
nr.7512 datë: 10.08.1991, kodin tregëtar (Ligjin 7638 dt.19.03.1992)
me akte të tjera të legjislacionit shqiptar.

O B J E K T I

Objekti i veprimtarisë private të shoqërisë "ALF SHPK"
do të jetë: "Tregëtimi me pakicë e shumicë i karburanteve; lubrifikat
arkikujve industrialë e ushqimorë, pjesë ndrimi për automjete e
pjete bujqësore, import-eksport si dhe shërbim servisi mekanik e
lavash makinash.



AFATI I VEPRIMTARISE

Vepрimtaria e shoqërisë private do të jetë efektivë nga dita e regjistrimit në regjistrin tregëtar në Gjykatën e rrëthit Tiranë, si dhe paisja me lejen e ushtrimit të vepрimtarisë private (profesionit) nga zyra e tatimeve dhe taksave Korçë.

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë "ALF SHPK" Korçë, përbëhet nga kontributi i ortakëve Lulëzim Ruka, Arjan Cerkollari dhe Alfred Cerkollari të cilët aritën vlerën 4.000.000 (katërmillion) lekë, tërësisht të shlyeshëm nga ana e tyre të rënshkruar dhe kanë depozituar në Bankën e Kursimeve Korçë një shumë prej 100.000 lekë (njëqindmijë).

Ortakët themelues të shoqërisë, kanë të drejtë që ~~xx~~ nxjere me nxjerjen e bilanceve periodik ose vjetorë të përfitojnë përqindjen e realizuar nga vepрimtaria private.

Shoqëria mban përgjegjësi për të gjitha detyrimet shtetëror sigurimet shoqërore etj.

JURIDIKSIONI

Shoqëria "ALF SHPK" Korçë e ka qëndrën në Korçë.

Të gjitha mosmarëveshjet me vendas apo të huaj, zgjidhen me mirëkuptim; në rastë të kundërt zgjidhen me gjykatë.

THEMELUESIT

ORTAKËT

Lulëzim Ruka

Arjan Cerkollari

Alfred Cerkollari

[Handwritten signature of Alfred Cerkollari]

[Handwritten signature of Arjan Cerkollari]



S T A T U T I

I

SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ALF S.P.K."

Në bazë të ligjit Nr. 7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, veprimtarive të pavarura dhe privatizimit", të Kodit Tregëtar dhe akteve të tjera ligjore, në Korçë sot më datë 20.06.1994, shtetasi Lulëzim Sefedin Rukaj banues në qytetin e Tiranës, Lagjia Nr.7 Laprakë Pallati Nr.6 shk.1/6; me vullnetin e tijë të lirë dhe të plotë në përputhje me legjislacionin shqiptar, vendosi të krijojë shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar "ALF SH.P.K." - Korçë.

K R E U I I -rë

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me përgjegjësi të kufizuar "ALF SH.P.K." Korçë është person juridik privat, ka të drejtë e detyrime për të cilat përgjigjet brenda kufijve të përcaktuar në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991, në Kodin Tregëtar dhe në akte të tjera ligjore.

NENI 2

Shoqeria ushtron veprimtarinë e saj private në bazë të ekonomisë së tregut të lirë.

NENI 3

Themeluesit e shoqërisë kanë derdhur kapitalin e tyre me qëllim që të mund të përfitojnë të ardhurat që do të vijnë

o / o

2.

nga veprimtaria private si dhe përballojnë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapitalin themelor.

NENI 4

Shoqëria "ALF SH.P.K." Korçë, është person juridik dhe si i tillë fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin në Gjykatën e rrëthit Tiranë dhe paiset me lejen për ushtrimin e veprimtarisë (profesionit) nga Zyra e Tatimeve e Taksave të rrëthit të Korçës.

EMRI, QËNDRA, TERITORI

NENI 5

Emri i shoqërisë do të jetë "ALF SH.P.K." Korçë, shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 6

Selia e shoqërisë është ~~në qendrën e tij~~, në Krogje Nr.7 Pallati Nr.6.

Shoqëria mund të zhvillojë veprimtari private në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të hapi edhe vendqëndrime të dyta, agjensi, përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë vendit, me miratim të organeve përkatëse dhe në mbështetje të legjislacionit shqiptar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 7

Objekti i veprimtarisë private të shoqërisë është "Tregëtimi me pakicë e shumicë i karburanteve, lubrifikanteve, artikujve industrialë, pjesë ndrimi për automjete e mjete bujqësore, import eksport si dhe shërbime servisi mekanik e lavash makinash".

3.

AFATI I VEPRIMTARISE

NENI 8

Vepritaria tregëtare e shqërisë do të zhvillohet për një afat prej 20 vjetësh, nga viti 1994 deri në 2014.

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 9

Kapitali themelor i shoqërisë "ALF SH.P.K.", përbëhet nga kontributi fillestar i kontribuesit të saj Z. Lulëzim Rukaj në vlerën 4.000.000 lekë (katërmilion lekë), terësisht e shlyeshme nga ana e tij, i mërshkruar dhe i depozituar në Bankën Tregëtare Tirana në shumë prej 100.000 lekë (njëqindmijë).

NENI 10

Kapitali mund të ritet, me zhvillimin e veprimtarisë ekonomike e financiare të shoqërisë. Zhvillimi i mëtejshëm i veprimtarisë ekonomike e financiare të shoqërisë për vitin në vazhdim, bazohet në përdorimin në vend dhe në kohën e duhur të kreditit afat shkurtër e afat gjatë.

NENI 11

Transferimet e kapitalit themelor duhet të vërtetohen me akt-roberie, shoqëria apo të tretët duhet të respektojnë këtë transferim apo ti bëhen në ditur asaj.

NENI 12

Pjesët e kapitalit themelor janë të transferueshme në rrugë trashëgimie, sipas ligjeve në fuqi.

NENI 13

Pjesët e kapitalit themelor mund t'u transferohen edhe



personave të tjerë të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, por gjithmonë me pëlqimin e themeluesit të shoqërisë.

NENI 14

Në rast të shtimit të numrit të ortakëve, me marëveshje, pjesët e kapitalit themelor, janë lirisht të transferueshme midis tyre.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

NENI 15

Shoqëria do të ketë si administrator z.Lulëzim Ruka, themelues i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ALF SH.P.K." i cili ka në kopitetë cilësitë e ortakëve.

NENI 16

Administratori ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe të kryejë të gjitha veprimet administrative të interes të saj.

NENI 17

Në marëdhënje me të tretët, organizatori organizon shoqërinë nepërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Në rastet kur administratori është i emëruar nga themeluesi i shoqërisë, kryen të gjitha veprimet e administrimit të shoqërisë, me përjashtim të atyre që janë në kompetencë të themeluesit të saj.

NENI 18

Ortakët themelues kanë kompetencë:

- Të miratojnë programin e shoqërisë, të hartojnë programin e administrimit, inventaret, llogaritë vjetore, të cilat nxirren të bazë të ligjit "Për kontabilitetin".



- Vendosin shpërbërjen e shoqërisë.
- Vendosin për mëdharjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve të murdëshme.
- Regullojnë marëdhërijet e punësimit e të shpërbllimit brenda shoqërisë.

- Sipas akteve ligjore, shlyejnë detyrimet ~~kipk~~ mëdaj organeve shtetërore e personave fizik e juridikë, vendas e të huaj, etjera.

NENI 19

Në rastë se administrimi i shoqërisë do të kryhet nga një administrator i zgjedhur posaçërisht nga ortakët themelues, këta të fundit miratojnë aktet e administrimit dhe karë të drejtë të informojnë personalisht për veprimtarinë e shoqërisë, të njihen me llogaritë dhe dokumentat e saj dhe të kërkojnë llogari.

NENI 20

Administratori humbet detyrën e ngarkuar në rast të prishjes së shoqërisë (osa kur shkarkohet ortaku i vetëm themelues i saj). Shkarkimi i administratorit bëhet në bazë të një akti me shkrim të themeluesit të shoqërisë. Në rast se shkarkimi nuk është i drejtë ai lë shkak për dëmshpërblim financiar.

KREU I II-të

MARËDHËNIET EKONOMIKO FINANCIARE

NENI 21

Shoqëria "ALF SH.P.K." mund të lidhë kontratë me sektorët shtetërorë drejt për së drejti me tregun e lirë si dhe persona juridik e fizikë, vendës e të huaj, sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 22

Në veprimet kontraktuale, shoqëria përfaqësohet nga z. Lulëzim Ruka ose persona të tjerë të autorizuar prej tijë.

NENI 23

Të drejtat dhe detyrimet që rjedhin nga kontrata, janë të detyrueshme për shoqërinë dhe punonjësit e saj.

NENI 24

Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal; afatet e derdhjes së tij. Ajo përgjigjet për detyrimet ndaj shtetit, si-gurimeve shoqërore si dhe për detyrimet ndaj të tretëve.

NENI 25

Për vazhdimësinë e veprimtarisë ekonomike, shoqëria ka të drejtë të vetë financohet në lekë shqiptare ose në valutë të huaj.

NENI 26

Shkëmbimin e monedhës shqiptare me monedhë të huaj ose anasjelltas mund ta bëjë në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose në tregun privat të valutës.

NENI 27

Të ardhurat e veprimtarisë private do të sigurohen nga tregëtimi i lubrifikaneve, vajrave, artikujve industrialë, pjesë këmbimi e shërbime servisi e lavazh, sipas objektit të veprimtarisë private. Shoqëria i cakton vetë qmimet e artikujve sipas të mësipërm.

NENI 28

Shoqëria ka të drejtë së transferojë jashtë shtetit kapitalin dhe pjesën e saj të fitimit në valutë. Për pjesën e fitimit që transferohet jashtë shtetit, ajo paguan një tatim prej 10%

7.

të shumës së fitimit që transferohet.



NENI 29

Për pasqyrimin e aktivitetit tregëtar, administratori ose ortakëve të shoqërisë, janë të detyruar të mbajnë dokumentacion të regjistrit financiar dhe regjistrat përkatëse.

NENI 30

Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqërisë mbaron në muajin dhjetor të çdo viti. Administratori është i detyruar të paraqesë bilance periodikë, bilance vjetore së bashku me deklaratën e fitimeve e humbjeve dhe t'i depozitojë ato në organin financier të juridiksionit përkatës, ku ushtron aktivitetin shoqëria.

KREU I III-të

MAREDHËNIET E PUÑES

NENI 31

Themeluesi i shoqërisë verdos për shtimin ose pakësimin e numrit të ortakëve dhe personave të tjerë që do të punësohen në veprimtarinë e shoqërisë "ALF SH.P.K.".

NENI 32

MAREDHËNIET E PUÑES FILLOWË ME REGJISTRIMIN E PUNONJËSVE
në librin e shoqërisë, duke u njoftuar edhe organi i punës të juridiksionit ku ushtron përfundimin e veprimtarinës shoqëria.

NENI 33

Marëdhëniet e punës regullohen sipas kontratës së lidhur lirisht midis palëve. Kontrata nëshkruhet nga administratori, pasi të jetë marë pëlgimi i themeluesve të shoqërisë kur ata kryejnë detyrën e administratorit. Shoqëria detyrohet të lidhë



edhe kontratën kolektive me sindikatat.

MENI 34

Ortakët e shoqërisë janë të detyruar të respektojnë disiplinën e punës dhe mbajnë përgjegjësi disiplinore për thyerjen e sajë.

MENI 35

Ndaj personave të punësuar që dëmtojnë pasurinë e shoqërisë zbatohen dispozitat e përgjegjësisë materiale, sipas Kodit të Punës

MENI 36

Kontrata e punës mund të lidhet me afat ose pa afat, sipas kritereve të përcaktuara nga ortakët e shoqërisë sipas ligjit "Për marëdhëni e punës".

MENI 37

Të punësuarit gjëzojnë lejen e zakonshme, leje plotësuese e tjera, në bazë të ligjit "Për regullimin e kohës së punës e të pushimit".

MENI 38

Mdryshimi dhe largimi nga puna bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga ortaku themelues Z. Lulëzim Ruka. Largimi bëhet me mbarimin e kontratës së punës, për shkak të shkeljeve të disiplinës së punës si dhe me vetë kërkesën e të punësuarit.

MENI 39

Punonjësit që largohen nga puna ose transferohen, duhet të bëjnë dorëzimin e detyrës në bazë të një akti me shkrim, pasi të kenë likujduar detyrimet materiale dhe monetare. Akti i mësipërm bëhet nga administratori i shoqërisë.

ELEMENTË TË TJERËNENI 40

Për zhvillimi dhe zgjerimin e veprimtarisë tregtare, shoqëria mund të marë truall për mërtime, me qëra ose në promësi, objekte, në bazë të kontratave përkatëse.

BILANCI EKONOMIKO FINANCIARNENI 41

Të ardhurat rreto pasi shlyhen detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore, shpenzimet gjithsej etj, kalojnë në promësi të shoqërisë themeluese ose ortakëve të tjerë në rastë se ka të tillë dhe mëdhen sipas kontributit të secilit.

NENI 42

Shpërbimi i administratorit dhe i personave të punësuar në veprimtarinë e shoqërisë, caktohen në kontraten e punës. Mëdryshimi në pagë vendoset nga themeluesit e shoqërisë

MM

NENI 43

Shoqëria përballon humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre fillestar në kapitalin bazë.

NENI 44

Fitimi që do të shpërndahet bërbëhet nga fitimi i vitit finansiar të cilat i janë zbritur ose shtuar humbjet apo fitimet nga vitet e mëparshme.

NENI 45

Kur pushon veprimtaria e shoqërisë, kapitali i mbetur, pasi shlyhen të gjitha detyrimet, mëdhet midis ortakëve sipas kontributit të tyre, ose i mbetet ortakut të vetëm themelues kur nuk ka ortakë të tjerë.

10.



NENI 46

Fitimi i mbetur kalon në pronësi të ortakëve themelues pasi janë shlyer detyrimet tatimore si dhe pagat e murdëshme për punonjësit.

SHPERBERJA E SHOQËRISË

NENI 47

Në rastë se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të konstatuara në dokumentetë financiarë rezultojnë më të vogla se gjysma e kapitalit themelor, ortakët themelues vendosin brenda katër muajve nga dita e konstatimit, murdësimë e prishjes së parakohshme të shoqërisë dhe mund të kërkojnë në Gjykatë prishjen e saj.

NENI 48

Gjykata mund ti afrojë shoqërisë një afat maksimal prej 6-muaj për të regulluar gjendjen. Ajo mund të prishë shoqërinë në rastë se ky regullim është bërë ditën në të cilën mblidhet për të marë vendim.

NENI 49

Në rastë se shoqëria nuk prishet, detyrohet të zvogëlojë kapitalin e sajë në një vlerë më të vogël se e humbjeve që kanë mbetur pa u mbuluar, duke patur parasysh që shuma e kapitalit të mbetur të jetë mbi 100.000 lekë (qëqirëdmijë).

DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 50

Themeluesit me rastin e shtimit të numrit të ortakëve ka të drejtë ti bëjë ndryshimet e nevojshme statutit dhe të hartoje kontratën e përbashkët me ortakët e tjerë duke bërë edhe ndryshimet

11.



e nevojshme në regjistrin tregëtar, pranë Gjykatës së Tiranës.

NENI 51

Mosmarëveshjet e Shoqërisë në marëdhënie me persona juridikë e fizikë, vendas dhe të huaj, zgjidhen me mirëkuptim dhe kur kjo nuk arihet zgjidhet nga Gjykata.

NENI 52

Përsa nuk është shprehur në këtë statut, ti referohet ligjit Nr.7512 datë 10.08.1991, Kodit Tregëtar të Republikës së Shqipërisë dhe qdo akti tjetër ligjor të legjislacionit shqiptar.

NENI 53

Statuti përpilohet në disa kopje, për tiu dorëzuar organeve kompetente. Një kopje e tijë mbetet si pjesë e dokumentacionit të formimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ALF SH.P.K." Korçë.

U mëshkrua sot në Tiranë më datë -----


THEMELUESI

Z. Lulëzim RUKA

